

ALBERT GJOKA

**DISA PRIRJE DHE DUKURI
NË PROZËN E SHKURTËR BASHKËKOHORE**

Letërsia shqipe është shfaqur kryesisht letërsi e tregimit (short story) pasi këtu e ka dëshmuar modernitetin e saj gjatë shekullit XX përmes tregimtarëve të tillë si Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi, Migjeni, dhe, për të vijuar më pas me Mustafa Greblleshin, Ismail Kadarenë, Faik Ballancën dhe Dhimitër Shuteriqin. Ky modernitet spikati edhe me emrat e Martin Camajt dhe Anton Pashkut, të cilët e zhvilluan krijimtarinë e tyre jashtë Shqipërisë. Mbi këtë traditë solide është ndërtuar dhe modeluar edhe tregimi bashkëkohor shqiptar, i cili ndërvepron brenda sistemit, por komunikon edhe me modelet e tregimtarëve botërorë. Në këtë punim janë përzgjedhur për objekt studimi tregimtarë si Mira Meksi, Ardian Kyçyku, Arian Leka, Arben Dedja, Romeo Çollaku, Lazër Stani, Gazmend Krasniqi, Ylljet Aliçka, Kim Mehmeti, Azem Qazimi, Teodor Keko, Kliton Nesturi, Ramiz Gjini, Faruk Myrtaj dhe Leonard Veizi. Ajo që konstatohet në tregimin bashkëkohor është se ka një shumëllojshmëri modelesh të lëvrimit të tregimit, ku shfaqen shenjat e një poetike të prozës së shkurtër postmoderne apo të tregimit fantastik, krahas konsolidimit të tregimit modernist. Madje, ka një shmangie nga rregullat e “tregimit klasik”, pra përmbysset rrëfimi i ngjarjes një apo shumëqelizorë, me skemën e tij tipike dhe kërkohen modele të reja. Autorët i janë përqasur tregimi në zhvillimin e koncepteve të unitetit, shkurtërsisë, intensitetit, tensionit, lirizmit, temës, thellësisë, vizionit dhe misterit, hibriditetit, fraktaleve dhe mbylljes. Tregimi i shkurtër shqiptar sjell përvojat e të jashtëzakonshmes, misteriozes, të çuditshmes, të të papriturës apo të pazakontës. Gjatë analizës së tregimit, konstatohet sendërtimi i tregimit në modelin borgesian, qoftë në instancat narrative që përdoren, qoftë në mënyrën e ndërtimit të historisë, prodhimit të misterit, investigimit etj. Tregimi shqiptar heton natyrën e reales, e cila tregon se është më komplekse sesa realiteti i dukjeve të thjeshta. Në këtë zhanër shfaqen elementet postmoderne të letërsisë shqipe, sepse tregimet janë verbalisht ndërtim

artefaktesh që fokusohen mbi realitetin e iluzioneve të reales. Më pas ata i bëjnë konvencionet artistike dhe mjetet artistike subjekt të fikSIONIT të tyre.

Fjalë kyçe: *proza e shkurtër shqipe, tregimi shqiptar, tregimi postmodernist, tregimi fantastik.*

Tregimi është një zhanër letrar dinamik, me identitet të debatueshëm, dhe që ndërvepron më shumë se asnjë lloj tjetër me zhanre të tjera letrare apo ekstra-letrare. Për shkak të natyrës së tij, ai ka tipare specifike në sistemet ku zhvillohet. Të tilla janë edhe tek proza e shkurtër shqipe, e cila ka shënjuar vlerat më të spikatura brenda sistemit letrar përgjatë një shekulli: Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi, apo Migjeni i dhanë modernitet letrave shqipe me tregimin e tyre në gjysmën e parë të shekullit XX. Edhe gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar pati tregimtarë si Anton Pashku, Ismail Kadare, Mustafa Greblleshi, Dhimitër Shuteriqi, Faik Ballanca, Martin Camaj, Sotir Andoni, Teodor Laço, Vath Koreshi, etj. që lanë gjurmë në këtë zhanër. Disa tregimtarë si Ismail Kadare¹, Mustafa Greblleshi, Faik Ballanca, dolën nga kornizat e metodës së socrealizmit, në krijimtarinë e tyre në prozën e shkurtër. Vitet '80 do të do të sillnin emra të rinj në këtë zhanër, si Nasi Lera, Kiço Blushi, Fahri Balliu, Zyhdi Morava, Diana Çuli, Bahri Myftari, Zija Çela, etj., por “pavarësisht nga arritja në aspektin e formës artistike, tregimi i kësaj periudhe nuk shquhet për ndonjë hop të madh cilësor”².

Gjatë tri dekadave të fundit është rritur interesi për prozën e shkurtër, si asnjëherë më parë dhe kjo duket në numrin e madh të botimeve që hidhen në qarkullim, qoftë nga autorë shqiptarë, apo edhe tregimtarë të

¹ Ismail Kadare e ka lëvruar tregimin, duke “eksperimentuar”, por secili prej tyre është përdorur më vonë si një bërthamë për të shkruar romane. Aty gjendet forma të tregimit modernist dhe postmodernist, por për shkak mjeshtërisë në prozën e gjatë, ai nuk e lëvroi tregimin vazhdimisht. Por, shenjat e para të antikonformizmit ndaj metodës së realizimit socialist, Kadare i dha në këtë zhanër. Ai ka paraqitur në vitin 1962 pranë Drejtorisë së Ndërmarrjes së Botimeve “Naim Frashëri” një vëllim me tregime, i cili mbeti i pabotuar për pesë vite me radhë. Për më shumë shih artikullin e Moikom Zeqos, *Letra e Kadaresë, 52 vjet më parë*, publikuar më 12 gusht 2018 në gazetën “Dita”. Shih linkun: <http://www.gazetadita.al/letra-e-kadaresë-52-vjet-me-pare/>.

² S. Gjoni, *Tregimi i viteve '80*, f. 184.

përkthyer në gjuhën shqipe³. Sot vlen të përmendim një brez prozatorësh që lëvrojnë këtë zhanër si: Kim Mehmeti, Ridvan Dibra, Arben Dedja, Gazmend Krasniqi, Shpëtim Kelmendi, Ardian Kyçyku, Mira Meksi, Kujtim Rrahmani, Ylljet Aličkaj, Azem Qazimi, Faruk Myrtaj, Lazër Stani, Romeo Çollaku, Arian Leka, Shkëlqim Çela, Agron Tufa, Ramiz Gjini, Neshat Tozaj, Albana Shala, Alban Bala, Eris Rusi, Eqrem Basha, Adil Olluri, Musa Ramadani, Mehmet Kraja, Leonard Veizi, Kliton Nesturi, Kujtim Dashi, etj.

Proza e shkurtër bashkëkohore shqipe zhvillohet mbi modelin e traditës së tregimit shqiptar nga njëra anë, por edhe në ndërveprim me tregimin klasik apo bashkëkohor botëror.

Specifikë në këtë zhanër shënon edhe zhvillimi në kohë të ndryshme i teorisë së “short story-t” e cila është artikuluar nga autorë si Edgar Allan Poe, Carl Gabo, Charles May, Boris Ejxenbaum, Frank O’ Conor, Suzanne C. Ferguson, Erich Kosh, Susan Lohafer, Carlos Fuentes, Viroica Patea, etj., të cilët jo vetëm kanë pasur në objekt studimi prozën e shkurtër, por kanë studiuar dinamikat edhe në raportet mes këtij zhanri dhe zhanreve të tjera letrare (romani, poezia, novela, përralla, mitet) apo raportet me disiplina të tjera ekstraletrare, si fotografia, kinemaja, skica, muzika, etj.

Një fenomen që është vënë re këto kohë është se ka një rritje të përkthimeve të tregimtarëve të njohur botërorë si, Jorge Luis Borges, Julio Cortazar, Alice Munro, Haruki Murakami, Raymond Carver, Carlos Fuentes. Këto vepra futen normalisht në një sistem si agjentë ndërveprues me tregimin shqiptar.

Ky punim ka në vetvete një objekt dinamik, me prurje të vazhdueshme, prandaj janë përzgjedhur vetëm disa nga autorët për objekt studimi në funksion të evidentimit të prirjeve dhe dukurive që po shfaqen në prozën e shkurtër bashkëkohore shqiptare. Tregimtarët e marrë në analizë në këtë punim janë: Mira Meksi, Ardian Kyçyku, Arian Leka, Arben Dedja, Romeo Çollaku, Lazër Stani, Gazmend Krasniqi, Ylljet Alička, Kim Mehmeti, Azem Qazimi, Teodor Keko, Kliton Nesturi, Ramiz Gjini, Faruk Myrtaj dhe Leonard Veizi. Përzgjedhja e autorëve përmban edhe një aspekt subjektiv, si lexues, dhe përfundimet e dala në këtë punim janë mbështetur mbi analiza jo të thelluara tekstesh të veprave më

³ Referuar të dhënave të Bibliotekës Kombëtare për tregimin e shkurtër të autorëve shqiptarë (përfshirë edhe tregimin për fëmijë) dhe atë të përkthyer, ka rritje të numrit të botimeve, përkatësisht: 65 (2014), 69 (2015) 77 (2016), 69 (2017). Gjatë viteve 2000 ka pasur numër më të lartë të botimeve me tregime, sesa këto pesë vitet e fundit; njëherësh shumë herë më i lartë se gjatëve viteve 1980-90.

përfaqësuese në prozën e shkurtër të këtyre autorëve. Po ashtu, tregimi i lëvruar nga autorë shqiptarë në Kosovë dhe Maqedoni është marrë në shqyrtim thuajse përciptas.

Prirje dhe dukuri

Autorët shqiptarë kanë një qasje komplekse, me këndvështrime të lloj-llojshme, ndaj realitetit që sendërtojnë fabulën/historinë në prozën e shkurtër. Tregimi shihet si një zhanër që rrok episodin, një fragment realiteti të kompresuar, një kujtim, një mbresë, një ëndërr, një lojë, një fabul, një gjëgjëzë, një mister, e kështu me radhë. Kohët e fundit konstatohet një rimarrje e realitetit të periudhës komuniste në Shqipëri. Këtu vlen të përmendin tregimtarët si Arben Dedja, Arian Leka, Mira Meksi, Ridvan Dibra, Ylljet Aliçkaj, Ardian Kyçyku, Lazer Stani, Albana Shala, etj. Ky realitet sendërtohet mbi shkëputjen fragmentare të ngjarjeve dhe kapjen e paradokseve të historive të përzgjedhura, të cilat shkaktjnë ndjesi tragji-komike tek lexuesi. Disa të tjerë janë të fokusuar tek realiteti i tranzicionit të shoqërisë së sotme, me dramat, krizën e identitetit, emigrimin, etj.. Këtu spikat edhe e ashtuquajtura “letërsia e kufijve”, me tregime të shkruara kryesisht nga autorë që jetojnë në emigrim, ku përmenden prozatorët si Faruk Myrtaj, Ramiz Gjini, Neshat Tozaj, Shkëlqim Çela, etj. Disa tregimtarë sjellin tematikat universale mbi dashurinë, urrejtjen, frikën, misterin dhe gjendje të tjera. Të tjerë përdorin përrallën, mitin apo forma të tjera të rrëfimit popullor si subjekte për të ndërtuar tregimet e tyre. Po ashtu, tregimi sot ndërtohet edhe si një ndërthyrje komplekse tekstesh, pra si një hiperealitet, ku bërthama mbetet realiteti artistik i një teksti tjetër. Një fenomen të tillë e shohim në tregimet e Mira Meksit, Arian Lekës, Gazmend Krasniqit, Ardian Kyçykit, Zija Çelës, etj.

Proza e shkurtër shfaqet shumëllojshme në mënyrën e ndërtimit të historisë. Referuar kësaj qasje, pra të tregimit të sendërtuar sipas tipologjisë së fabulës/historisë, në numrin e ngjarjeve që përfshin⁴; kostatojmë tregimin një qelizor, pra tregimin me një ngjarje (Ramiz Gjini, Zija Çela, Ridvan Dibra, Albana Shala, Teodor Laço, Kliton Nesturi, Ylljet Aliçkaj), tregimin disa qelizor, pra tregimin që përmban dy ose më shumë ngjarje brenda tij (Mira Meksi, Lazer Stani, Gazmend Krasniqi, Kim Mehmeti, Azem Qazimi, etj.) dhe tregimin pa histori, ose anti-histori

⁴ Këtë klasifikim e ka përdorur Carl Crabo në veprën e tij *The art of the short story*. Një tregim mund të ndërtohet me një histori që përmban një ngjarje/incident apo me disa ngjarje/incidente. Për më shumë Shih: Carl H. Crabo, *The art of the short story*, “Charles Scribner’s Sons”. - New York, Chicago, Boston, 1913.

(tregimi i Ardian Kyçyikut, Arian Lekës, etj.). Tregimi me një ngjarje kryesisht ndërtohet mbi një episod, gjëegjëzë, ëndërr, vegim etj. Tregimi shumëqelizor, i cili përmban më shumë se një ngjarje, ka qenë dhe vazhdon të jetë i pranishëm në letrat shqipe. Ndërsa tregimi pa histori është një prurje e re në këtë zhanër në prozën e shkurtër shqipe, pasi ai është tipik për letërsinë postmoderne e cila e zhbën historinë.

Shihet se ka një përpjekje të autorëve shqiptarë për të përzgjedhur me kujdes subjektin mbi të cilin ndërtohet tregimi. Tregimtari dhe teoricieni i prozës së shkurtër Julio Cortázar thotë se “subjekti nga i cili do të dalë historia e mirë është gjithmonë i jashtëzakonshëm”, - por me këtë ai nuk kupton se një subjekt duhet të jetë i jashtëzakonshëm, i padëgjuar, misterioz apo unik. Përkundrazi, ai mund të jetë rreth një gjëje tërësisht të vockël, dhe që ndodh në përditshmëri. “Ai është i jashtëzakonshëm sepse është si një magnet; një subjekt i mirë nxit një sistem të tërë të historive të ndërlikdhura, ai ngurtëson tek autori dhe më vonë, tek lexuesi shumë koncepte, vështrime, ndjenja, dhe madje ide të cilat rrjedhin virtualisht në kujtesën apo ndjeshmërinë e tij. Një subjekt i mirë është si një diell i mirë, një yll, me një sistem planetar rreth tij, për të cilin ne ishim të pavetëdijshëm derisa rrëfimtari, astronomi i fjalëve, na e zbulon”⁵.

Përgjithësisht tregimi shqiptar e ndërton narracionin në rend logjik (shkak-pasojë) apo në rendin kohor, por tashmë po shfaqet tregimi që e shprish këtë rend.

Në aspektin narrativ, konstatojmë lëvrimin gjerësisht të tregimit homodiegetik⁶, dhe më konkretisht, ai autodiegetik, tipar ky i tregimit postmodernist. Për shkak të natyrës së tij, narratori autodiegetik, pra ai narrator që është edhe personazh dhe rrëfen, është më e lehtë për t’u ndërtuar misteri, tensioni dhe e pazakonta. Por, ndryshimet më të mëdha në aspektin narrativ në tregimin shqiptar po shfaqen në mënyrën e përdorimit

⁵ J. Cortázar, *Some aspects of the short story* (Marrë nga libri “The new short story theories”, përgatitur nga Charles E. May; Ohio University Press, SHBA, 1994, f. 248.

⁶ Termi “narrator homodiegetik” i referohet përkufizimit të Gerald Princ ku narratori është pjesë e diegesis; pra kemi një narrator që është personazh në situatat dhe ngjarjet që tregon. Brenda kësaj kategorie futet edhe narratori autodiegetik, i cili ka rol të dyfishtë; rrëfen dhe vepron si personazh në vepër. Shih, *A dictionary of narratology*, Gerald Princ, Universiteti i Nebraskës, 1987.

të pikës së pamjes⁷, përmes përpunimit të teknikave të fokalizimit dhe perspektivës. Gjithsesi, përdoret ende gjerësisht rrëfimi heterodiegetik⁸ tek tregimtarët shqiptarë, i cili përdoret më së shumti tek romani.

Po ashtu, personazhi ka pasur rëndësi të veçantë në ndërtimin e tregimit. Madje, aktualisht ka shumë prozatorë që e konceptojnë tregimin si elaborim i botës së brendshme të personazhit. Mes tyre vlen të përmenden Leonard Veizi, Lazer Stani, Romeo Çollaku, Arben Dedja, etj. Por, ka edhe tregimtarë që e zhbëjnë personazhin në tregimet e tyre.

Kostatimet e mësipërme dëshmojnë se tregimi bashkëkohor shqiptar po zhvillohet përkatësisht sipas modeleve të tregimit modern⁹ dhe atij postmodern¹⁰, si një proces i gjallë kërkimi dhe eksperimentimi formash. Shfaqja e tregimit postmodern në prozën e shkurtër shqipe meriton vëmendje, pasi ka filluar të lëvrohet kryesisht gjatë dy dekadave të fundit. Këtu vlen të përmenden autorët si Mira Meksi, Arian Leka, Ardian Kyçyku, Gazmend Krasniqi, por edhe autorë të tjerë. Këtu shihet se

⁷ Termi “pikë pamje” i referohet përkufizimit të Gerald Princ i cili quhet “pozicion perceptues ose konceptues në bazë të të cilit prezantohet situata apo ngjarja narrative”.

⁸ Termi “narrator heterodiegetik” i referohet përkufizimit të Gerald Princ ku “narratori nuk është pjesë e diegesis; pra kemi një narrator që nuk është personazh në situatat dhe ngjarjet që tregon. Ky lloj narratori është tipik për zhanrin e romanit. Për më shumë, shih, “A dictionary of narratology”, Gerald Princ, Universiteti i Nebraskës, 1987.

⁹ Karakteristikat formale kryesore të tregimit modern janë: Kufizim dhe vënie në plan të parë të pikës së pamjes, theksim mbi paraqitjen e ndjeshmërisë dhe përvojës së brendshme, heqje ose transformim të disa elementeve të fabulës tradicionale, përmirësim i sigurt i metaforës dhe metonomisë në paraqitjen e ngjarjeve dhe rrethanave, refuzim i rendit kohor kronologjik, ekonomi formale dhe stilistike dhe vënie në pah të stilit. Për më shumë shih: *Defining the short story* nga Suzanne C. Ferguson dhe *Chekhov and modern short story* nga Charles E. May. *The new short stories theories*, përgatitur nga Charles E. May, Ohio University Press, Athens. - SHBA, 1994.

¹⁰ Tregimi postmodern nisi në mesin e shekullit XX dhe përfaqësuesi më i spikatur i saj është Borges. Tiparet kryesore të tij janë: Historia shndërrohet në anti-histori; fabula humbet marrëdhëniet shkak – pasojë, realitetet shfaqen përmes copëzave, asgjësohet personazhi dhe mjedisi është thjeshtë artific, simbolet ndërlikohen duke kapërcyer veten. Ky lloj tregimi është zhvilluar bazuar mbi postmodernizmin si lëvizje kulturore dhe letrare, ku arti postmodern rivendos rregullon, demistifikon procesin tonë të përditshëm, strukturon kaosin, komunikimin, përcaktimin e kuptimit”. Për më shumë shih *Poetika e postmodernizmit* e Linda Hucheeon, përktheu Demë Topalli, Botimet OM. – Prishtinë, 2013.

ndikimin më të madh e ka Borges, si një ndër përfaqësuesit e spikatur të tregimit postmodern. Tek Mira Meksi dhe Azem Qazimi vjen natyrshëm, edhe në forma më konkrete intertekstuale si “vegimi”, apo “vjedhja”, krahas shfaqjeve më të avancuara, sepse ata janë njëherësh edhe përkthyes të prozës së Borgesit në shqip. Në tregimet e tyre shihen përngjasime në strukturën narrative të tregimit, instancat narrative, ndërtimin e tensionit apo misterit, përdorimin e elementeve intertekstuale, etj.

Tek Mira Meksi kanë ndikuar autorë të letërsisë hispanike si Carlos Fuentes, Gabriel Garcia Marquez, Julio Cortazar, Borges apo edhe autorë të tjerë. “Arkitektura e tregimit të kësaj autoreje shfaqet si gërshetim kompleks, me ndërveprim zhanresh; me esenë, me poezinë, me mitin, me pikturën, fotografinë etj., përmes një mekanizmi analitik, ku mbushen me informacione të natyrës enciklopedike dhe me referenca konkrete nga bota reale”¹¹.

Pjesa më e madhe e tregimeve janë kryesisht produkte intertekstuale. Tekste nga vepra letrare botërore (“Alef”, “Don Kishoti”, “Aura”) shërbejnë si tekste bazë për të ndërtuar një tekst të ri letrar. Lëvrimi i këtij lloji tregimi është një prurje që i jep një modernitet prozës së shkurtër shqipe. Në librin “Flutura mes gjinjëve”¹² ka shumëllojshmëri eksperimentimesh narrative dhe elemente të rinj poetikë, ashtu siç ka një origjinalitet dhe mjeshtri në mënyrën sesi përzgjidhet dhe ndërtohet historia, si përdoret intertekstualiteti, si realizohet mistikja përmes elementeve të tensionit, të papriturës, investigimit, etj..

“Tregimi i Mira Meksit është një ndalesë në prozën e shkurtër shqipe; është një shtegtim i sigurt drejt postmodernes në letrat shqipe. Me një prozë të tillë të shkruar në gjuhën shqipe, gjendemi në sintoni me zhvillimet më të fundit të prozës bashkëkohore europiane dhe botërore”¹³.

Modelin borgesian të tregimit e lëvron Gazmend Krasniqi¹⁴, sidomos në përdorimin e instancave narrative (tregimi stafetë) apo në gërshetimin e diskurseve kulturore brenda në prozën e shkurtër. Proza e shkurtër e këtij autori është produkt intertekstual dhe, si e tillë, receptimi komplikohet për lexuesin e zakonshëm. Ai është produkt i përdorimit të teksteve të tjera letrare ose jo-letrare: “Rrethimi i Shkodrës” i Marin Barletit në tregimin me të njëjtin titull, novela “Rrunggajë në mars” e Martin Camajit tek tregimi

¹¹ A. Gjoka, *Risi në prozën e shkurtër shqipe*, revista letrare-kulturore online, Palimpsest, nr. 2.

¹² M. Meksi, *Flutura mes gjinjëve*, Onufri. Tiranë, 2017.

¹³ A. Gjoka, *po aty*.

¹⁴ Shih, G. Krasniqi, *Nëse një ditë një prelud*, Onufri. Tiranë, 2014.

“Kthjelltësia e papërballueshme e zhgjëndrës”, etj. Autori e kërkon “domethënien” e realitetit tek vetë ngjarjet apo personazhet reale, dhe mbi to ndërton një tekst letrar. Tregimi ndërtohet mbi një diskurs kulturor, ku ngjarje historike, personalitete të artit dhe letërsisë shërbejnë si lëndë për të sendërtuar fictional-en.

Azem Qazimi¹⁵ është njëherësh edhe përkthyes i prozës së shkurtër të Borges, dhe në tregimin e tij mbase është më i ndikuari në radhët tregimtarëve që ndjekin modelin borgesian. Një gjë e tillë duket që në përdorimin e “elementeve paratekstuale”, kapjen e historive mbi të cilat ndërton tregimin, por edhe në elementet e tjera të brendshme, si instancat narrative, etj. Fictioni ndërtohet mbi faktin real, mbi ngjarjen historike, si një proces hetimi. Narracioni ngjan më shumë me diskurse të tjera si eseja, apo teksti historik.

Mes autorëve që lëvrojnë sot tregimin postmodern është edhe Arian Leka. Ky zhvillim ka ardhur si proces natyrshëm pas disa vëllimeve me tregime, ku ka lëvruar tregimin modern¹⁶. Ai e ka përsosur teknikën narrative në tregimin modern, duke i kushtuar vëmendje përzgjedhjes së historisë (tek tregimi “Academic Orgasm”, “Qelë prej letre”), duke i dhënë rëndësi detajit (“Fli me dritë ndezur”), duke tipizuar mjeshtërisht personazhin duke përdorur tensionin (tek tregimi “Gjelina e madhe”, “Album me Xhabir dhe Xhebrahil”) dhe misterin (tek tregimi “Zogjtë e pikturave”), duke sjellë modele të reja narrative (tregimi “Pema”). Tregimi postmodern vjen si një eksperimentim i guximshëm, ku humbet historia, dhe proza e shkurtër ndërtohet një si një ndërthyerje komplekse e disa teksteve, zhanreve letrare apo diskurseve të ndryshme. Tregimet më tipike janë “Arma sekrete”, “Dritare nga fusha”, “Krijimi i njeriut të ri”, “E shtrembër”, etj.

Mes tregimtarëve më të spikatur në këtë grup është Ardian Kyçyku, i cili i jep një fytyrë origjinale prozës bashkëkohore. Tregimi është pjesë e një procesi tërësor të krijimtarisë së tij në prozë, ku vijnë copëza surreale të një mjedisi ku gjallon “homo ideologicus”, - qenia që ka humbur çdo individualitet; një njeri pa identitet, i cili është pa qëllim në jetë për shkak të humbjes së kuptimit dhe misionit. Ky individ shfaqet përmes përzierjes së qëllimshme të llojeve të ndryshme të diskurseve dhe kodeve të

¹⁵ Shih A. Qazimi, *Anatomi e shkurtër pikëllimi*, botimet Zenit, 2015. Ai ka shkruar edhe vëllimin *Të bekuarit, sfera* (2005).

¹⁶ Shih vëllimet *Ky vend i qetë ku s'ndodh asgjë* (1994), *Veset e të vdekurve*, (1997), *Shpina e burrit* (2005, ribotimi 2017), por edhe tregimet e botuara në gazetën “Drita”, në revistën “Mehr Licht”, etj. të A. Lekës.

pakuptueshme në gjuhën e personazheve apo realiteteve. Këtu duhet kërkuar edhe kuptimi/semantika e titullit të vëllimit më përfaqësues me tregime “Tregime të padukshme”. Pra, kemi tregimin pa histori, ose tregimin anti-histori, që kap copëza fragmentesh, të realiteteve dhe diskurseve të ndryshme, tipar i tregimit postmodern.

“Fragmentaritetin, momentin statik, të kapur, fluturak, një mënyrë apo një nuancë tregimi modern e kthen brenda një historie pa histori. Ai bëhet një vend për njohjen e gjendjeve të vetëdijes dhe perceptimeve impresionuese të realitetit, duke reflektuar një shumëfishim të pikëpamjeve me karaktere të konceptuara kryesisht si regjistra të ndryshëm”¹⁷.

Një tjetër tregimtar që ka sjellë një profil interesant në prozën e shkurtër shqipe të pas viteve '90 është Kim Mehmeti¹⁸, i cili e ka sendërtuar rrëfimin e tij përmes gërshetimit të tregimit kutelian dhe të atij të realizmit magjik. Për të tregimi është mister dhe të gjitha teknikat narrative vihen në funksion të ndërtimit të misterit. Dy prej tipareve të realizmit magjik, që kanë evidentuar studiuesit gjenden në shumicën dërrmuese të tregimeve të Kim Mehmetit: “Shkrirja e reales me fantastiken: Mund të jetë një kontekst fantazie me personazhe realë, ose një kontekst real me personazhe fantastikë” dhe ëndërrimi; protagonistët e intrigës zakonisht shpesh shtjellohen dhe veprojnë në terren ëndërrimi. Rrëfimet shumë herë nisin në ëndrra që shohin personazhet apo edhe vetë historitë zhvillohen në terrenin e ëndrrave, si skenar që tregimi të bëhet më tërheqës”¹⁹. Lënda mbi të cilën ndërtohen tregimet magjike/mistike është sa lokale, aq edhe universale. Kujtesa, ëndrra dhe e shkuara futen në filtrin e metodës së realizmit magjik, paçka se nuk mund të shmanget as ndikimi që ka proza kuteliane. “Fshati pa varreza”, “Shtëpia në fund të fshatit”, “Oda e burrave”, ndonëse flasin me një gjuhë artistike universale, rrokin drama kontekstuale të jetës së shqiptarëve si drama e izolimit dhe mungesa e kujtesës, pasojat e indiferencës ndaj jetës komunitare dhe dekodimin maskilist të një shoqërie partiarkale si kjo e jona. “Fati i Fatushes” është një shikim i të kaluarës, rigjallërim i kujtesës përmes fotografisë/albumit,

¹⁷ *The short story: An overview of the history and evolution of the genre*, edited nga Viorica Patea. – Amsterdam – New York, 2012.

¹⁸ Analiza është bërë bazuar mbi përmbledhjen me tregime *Anemona*, botuar nga Botimet Naimi, 2017. Vetë autori shfaq pretendime për veten si tregimtar në parateksin që shoqëron këtë botim: “Herët e kuptova se proza, e veçanërisht tregimi, është Makondoja ime krijuese, ku ndihem sundues i mirë dhe i sigurt”.

¹⁹ B. Karaballi, *Pak fjalë për realizmin magjik*, Palimpsest, shih linkun: <https://palimpsest.al/2018/05/pak-fjale-per-realizmin-magjik/>

ndërsa “Nga ëndrrat e gjyshes” është një dedikim i arrirë për gjyshen, e cila përcjell jo thjesht kujtesën e domosdoshme mes brezave njerëzore, por ruan edhe magjinë njerëzore.

Zija Çela është ndër tregimtarët më të spikatur, i cili ka nisur ta lëvrojë këtë zhanër që në mesin e viteve '70 të shekullit të kaluar. Mjeshtëria e rrëfimit të tij nga lëvizur natyrshëm që nga tregimi modernist çehovian, ku historia ndërtohet mbi detajin (autori shfaq mjeshtri në përdorimin e detajit në tregime si “Galabuni”, “Bacaloku”, “Qyrku”, “Lara e shqarshit”, “Eklips”, etj.) deri tek tregimi fantastik²⁰, tipar ky i krijimtarisë së lëvruar pas viteve '90 nga ky autor. “Në prozën e Zija Çelës realja dhe arealja shkrihen me njëra-tjetrën për ta shpalosur jetën individuale dhe kolektive e jo për ta mbuluar atë me mjegull e paqartësi”²¹. Autori përdor pa sforcim strategjitë për ndërtimin e fantastikes në tregimin e tij: Si është ndërtuar bota, karakterizimin, gjuhën që përdorur, ndikimin e narratorit, fokalizimin dhe format e veçanta narrative dhe së fundi kompozimin e narracionit. Përdorimi në nivel të lartë të të gjitha këtyre elementeve i japin dimensionin e fantastikes tregimit të Zija Çelës. “Lexuesi shqiptar, i cili tani mund të lexojë Markesin, Sabaton, Kunderën, Buzatin, Kalvinon, Grasin, njësoj si Xhojsin, Prustin, Sartrin, Kamynë, mund të lexojë me endje edhe Zija Çelën, sepse nga njëra anë ai sublimon arritjet e mëdha të prozës së shekullit të XX në ndërtimin e fakturës tekstore dhe të prosedeut, ndërsa nga ana tjetër, me tematikën e veprave të tij qëndron afër preokupimeve të botës shqiptare”²².

Lazër Stani mbetet ndër tregimtarët më “besnikë” të tregimit modernist shqiptar, zhvillues i traditës së tregimit shqip, i pandikuar aq shumë nga tregimtarët e huaj, por që synon t'i kushtojë më shumë rëndësi historisë sesa rregullave strikte të narracionit. Ai e ka lëvruar rregullisht këtë zhanër për rreth 30 vjet me radhë²³. Stani tenton të jetë vetvetja në

²⁰ Këtu i referohemi konceptit të Cvetan Todorovit, sipas të cilit “fantastikja është hezitimi që përjeton një qenie njerëzore, e mësuar vetëm me ligjet e natyrës, përballë një fenomeni në dukje të mbinatyrshëm”. Për më shumë shih *Hyrje në letërsinë fantastike* (përkthyer nga Gjovalin Kola), Pika pa sipërfaqe. - Tiranë, 2015, f. 32.

²¹ Akademik A. Aliu, *Kur shpirti hapet për universin njerëzor* (parathënie e vëllimit “Pika drite në eklips”, Botimet Toena. – Tiranë, 2012.

²² M. Kraja, *Aventura e njohjes: sprovë për një portret*, gazeta Shekulli, 26 tetor 2009, f. 18-19.

²³ Lazër Stani ka shkruar vëllimet me tregime: *Misteri i hijeve* (botim i Shtëpisë Botuese të LSHA-së, 1993); *Shplakja e Santa Marisë* (botim i Shtëpisë Botuese

prozën e tij: “Ne biologjikisht nuk jemi të pandotur, përderisa mbajmë në trup gjenet e paraardhësve, e megjithatë jemi origjinalë, të përvetshëm e të papërsëritshëm, jemi secili një histori unike. E tillë është edhe letërsia, kur ajo është letërsi, i tillë është edhe shkrimtari kur ai është shkrimtar”²⁴. Që nga fillimet deri në botimin më të fundit, “Kohë për nuse” Stani ka tentuar që të strukturojë identitetin e vet si tregimtar. Vëllimi më i fundit, sipas studiuesit Anton Nik Berisha, “dëshmon një rrafsh kulmor të artit poetik të Lazër Stanit, po edhe të tregimit bashkëkohor shqiptar në përgjithësi”²⁵.

Stani nuk shpërndahet nga areali prej nga vjen në origjinë, nuk e lë kujtesa, as plagët e së shkuarës apo të së tashmes, e bashkë me to, as fantazia; dhe përmes mjeteve narrative të mbajtura mirë nën kontroll, ndërton tregimin e tij. Realiteti i rrokur në prozën e shkurtër është dramatik, ku fatet njerëzore lëvizin në sisteme të izoluar apo në tranzicion, dhe individit lufton për të shpalosur vetveten.

“Pasi lexon tregimet e tij ndjen se nuk është thjesht e vërteta ajo që të miklon shpirtin e mendjen, por mundësia për të njohur rrugën drejt saj. I kërkon ngjarjet në të shkuarën, i gërsheton ato me të tashmen duke ndërtuar rrathë që ndërpriten me njëri tjetrin, e pikërisht në këtë sipërfaqe që i përket dy kohëve, ndërton tregimet e tij Lazër Stani. Mendoj se kjo është një gjetje artistikisht e arrirë. Ëndrra e tij, më shumë se dëshirë, është mungesë e kjo mungesë kthehet në traumë”²⁶.

Përtej këtij këndvështrimi, në tregimin e Lazër Stanit nuk mungon as shija e hollë e ironisë që endet natyrshëm në rrëfimin e tij.

Ashtu si edhe Zija Çela apo Lazër Stani, Romeo Çollaku përpiqet të përdorë të gjitha teknikat e tregimit modernist. Në tregimet e tij lëvrohen sa temat universale, si vdekja e perceptuar në sytë e një fëmije (shih tregimin “Katërkëndëshi i Bermudajve”), raporti i individit me mjedisin/objektet (shih tregimin “Liqeni”), aq edhe dramat sociale të një shoqërie siç është Shqipëria post-komuniste (shih tregimet “Të

“Eurorilindja”, 1995), *Në Bregenc shkohet për të vdekur* (botim i shtëpisë Botuese “Albinform”, 1998); *Feniksi i kuq* (botim i Shtëpisë Botuese “Buzuku”, 1999), *Dënesje në dru* (Ideart 2005), *Kohë për nuse* (Botimet Fishta 2016).

²⁴ L. Stani, *Rruga pa krye* – ese letrare, botimet Fishta. – Lezhë, 2016, f. 71-72.

²⁵ A. N. Berisha, *Mëvetësi e shtresimit dhe e mbindërtimit poetik të rrëfimit*, - pasthënie e librit “Kohë për nuse” e Lazër Stanit, Botimet Fishta. – Lezhë, 2016, f. 173.

²⁶ L. Dushi, *Lazër Stani: Tregimtari i përjetshëm*, Për më shumë, shih linkun: <http://www.mapo.al/lazer-stani-tregimtari-i-perjetshem>

internuarit”, “Zeja e përunjur e bukëpjekësit”, “Rrugë”), vetmia dhe zvetnimi i marrëdhënieve në çift (shih tregimin “Bijat”). Çollaku është një vëzhgues i hollë, që kërkon të shkojë përtej shfaqjes së realitetit për të përcjellë dramën e një shoqërie në tranzicion.

Në prozën e shkurtër shqipe është shfaqur edhe tregimi parodik, të cilin e kanë nga prozatorët si Arben Dedja, Ylljet Aliçka, Shkëlqim Çela, etj. Në tregimin e traditës shquhet Zija Çela i cili është mjeshtri i ironisë në rrëfimet e tij. Më së shumti këtë lloj tregimi e shohim të lëvruar para viteve ’90.

Arben Dedja²⁷ është një zë ndryshe në prozën bashkëkohore: Për të, realja është më komike, apo më tragjike se vetë arti; e vetmja aftësi e tij është se di të fiksojë kuadro/çaste të realiteteve dhe t’i sjellë ato para lexuesit, besnikërisht, ashtu siç janë, pa i hequr asnjë presje: qoftë realitetin e para viteve ’90, qoftë edhe realitetin që jetojmë sot. Si të tilla këto “frame”, shkaktojnë paradoksin me kohën në të cilin ndodhet lexuesi, e çudisin, e habisin dhe i shkaktojnë ndjesi të shumta tragji-komike. Dedja është mjeshtri i zbërthimit të kohës – shenjë, duke i fiksuar diskurset e saj, që artikulohej thjeshtësisht përmes personazheve. “Prindër në 8-vjeçare” është tregimi që mpiks realitetin në kohën e komunizmit, i parë përmes këndvështrimit të një/shumë vajzave (Rrëfim në vetën e parë njëjës/shumës): Divorci, birësimi, jetimi, vetëvrasja, arrestimi, deklasimi, diskrimini, janë fenomene sociale që vijnë të gjalla për ata që e kanë njohur atë realitet, dhe si sureale për brezin e ri. Bota e fëmijëve shfaqet në këtë përmasë edhe te tregimi “Pushkini dhe unë”. “Në kullën e mishit” është “thrilleri” i spitaleve tona, ku jeta dhe vdekja i ndan veç një fije e hollë kujdesi/pakujdesi. Rrëfimi është ndërtuar në formatin e një ditari të një mjeku të urgjencës dhe sjell realitetin tragjiko-komik të sistemit shëndetësor. Teksti i Arben Dedja konsiderohet shenja e kohës tonë, ku përmes teknikës së rrëfimit, e çmitizon mitin tonë të përbashkët, e zhvesh dhe e sheh me lakuriqësinë e tij; këtu gjendet çelësi i ndërveprimit të veprës me lexuesin.

Në këtë linjë shfaqet edhe tregimi i Ylljet Aliçkaj. Tregimet “Rrëfimet e një poeti”, “Histori njerëzish të zakonit”, “Koha e puthjeve” apo “Një ditë në koçek” sjellin fragmente të jetës në komunizëm, ku autori

²⁷ Arben Dedja, i lindur në vitin 1964, me profesion mjek, që jeton dhe punon në Itali, me vetëm pak krijimtari ka arritur të fitojë vlerësime dhe çmime kombëtare si prozator. Ai ka shkruar vëllimet me tregime *Histori eskatologjike* (Pika pa sipërfaqe, 2014) dhe *Kulla e mishit* (Pika pa Sipërfaqe 2016). Në këtë punim është marrë në analizë vëllimi *Kulla e mishit*.

i qëndron besnik realizimit të diskursit identik të asaj kohe, duke e mbushur me leksik dhe pasuri zakonesh, traditash dhe mendësish që i përkisnin asaj kohe. Tregimet si të tilla shkaktojnë ndjesi komike dhe tragjike njëherësh.

Në tregimin e sotëm lëvrohet edhe ai që quhet tregimi “amerikan”²⁸. Më i spikaturi mes tyre është Ramiz Gjini, por ka edhe tregimtarë të tjerë si Faruk Myrtaj, Teodor Keko, Shkëlqim Çela, etj. Ky tregim nuk strukturohet i tillë për shkak të ndërveprimit që prozatorët shqiptarë kanë me prozën e shkurtër të lëvruar në Amerikë të autorëve si William Sarojan, O’Henri, Raymond Carver, Alice Munro, etj., por adoptohen elemente specifike të poetikës së kësaj proze: Këtu tregimi ndërtohet mbi detajin, episodin, mbi një parabolë, apo gjëgjëzë. Autorët i marrin personazhet nga realiteti i zakonshëm.

Mes tyre shquhet për origjinalitet në lëvrimin e tregimit Ramiz Gjini²⁹, i cili ka lëvruar rregullisht tregimet që nga vitet ’80. Proza e tij kapet në momentet e thjeshta të jetës, në çastet që kanë domethënie, por që vijnë si histori të zakonshme. “Realiteti është gjëja më e parrokshme dhe asnjëherë e përcaktuar drejt ashtu siç duhet. Por, shkrimtari mund të flasë për një vezullim që e ka burimin tek realiteti, për një si shfaqje e një momenti suksesiv, gjithnjë e dyshimtë dhe kurrë e përkufizuar ashtu siç duhet”³⁰. Tregimi i tij e fsheh faktin, duke u shndërruar në një lojë, që lexuesi pritet ta zbulojë. Proza e shkurtër e tij është e ndërtuar duke kapur mjedise kryesisht rurale, të cilat vijnë të gjalla me gjuhën e gjallë plot dialektizma, zakonet dhe traditat e tyre (jeta në trevat e Dibrës), ku shndërrimi në tregime realizohet përmes një përpunimi të thelluar të

²⁸ Ky lloj tregimi është i njohur për dramë, narracion logjik, besueshmëri reale, realizëm, miniatura të personazheve, mbarështim logjik të tërë tekstit, gjë që e bën një realizëm tërësisht argëtues (gjithsesi nënkuptuar dhe idenë, filozofinë dhe metaforën brenda tyre). Këtu mund të futen tregimtarë si Ramiz Gjini, Faruk Myrtaj, etj. Termat “tregim evropian” dhe “tregim amerikan” janë përdorur nga Ballsor Hoxha. Shih *Dy udhë letrare përmes tregimit të Kosovës*, tek revista Saras, linku: <http://revistasaras.al/2016/02/02/dy-udhe-letrare-permes-tregimit-te-kosoves/>

²⁹ Ramiz Gjini ka filluar që të shkruajë para viteve ’90 dhe deri më tani ka botuar këto libra: *Dush varrezash* (1998), *Këpucët e të tjerëve mbi trotuar* (1999), *Atdheu prej dëbore* (Plejad, 2003), *Mendjet e njerëzve* (Plejad 2005), *Rrëfime në hije*, (Botimet M&B, 2008), *Posta që sjell era* (Botimet M&B).

³⁰ R. Gjini, *Punëtori i thjeshtë i shkrimtarisë ose letërsia mes meje dhe teje*, botuar tek revista online fjala review. Shih linkun: <http://www.fjalaelire.com/tema/33385.html>

historisë, e cila vjen e formësuar edhe nga leximet e shumë tregimtarëve klasikë apo bashkëkohorë. Brenda zhanrit të tregimit ai lëvtron disa lloje të tij, tregimin që rrjedh nga anekdota (shih tregimet “Krimbi”, “Për veten tënde e ke, zotni”, “Një histori dembelësh”, “Kur heronjtë flenë”), tregimi që rrjedh nga përralla (shih tregimet “Isaku, vëllaçkoja ynë i vogël”, “Hiçi dhe diçi”); tregimi si lojë (shih tregimet “Ana Luigji”, “Mërzia e thellë e vetmitarit Luis Median”); tregimin që rrjedh nga mendimi filozofik (shih tregimet “Stacioni i fundit”, “Grueja e huaj”, “Hapat e të tjerëve mbi trotuar”, “Turma”, “Plagë lulezonje”, Arka e mbyllur”, “Frika”), tregimi si mister (shih tregimet “Shpirti i shtëpisë së vjetër”, “Ara e pakorrur”, “Macja e zezë”); tregimin parodik (shih tregimet “Qeveritarët”, “Belaja e së shtunës”, “Rrëfimi i bariut”), etj. Proza e shkurtër e Ramiz Gjinit është edhe zbavitëse, edhe fshikulluese, edhe misterioze, edhe reflektuese, edhe intensive, falë njohjes së teknikave narrative, ndërtimit të strukturës së tregimit modernist, këndvështrimit të historisë, gjuhës së pasur, të mbushur me dialektizma, fjalë të reja, si dhe elementeve të tjerë. Sipas pikëpamjes tonë, Ramiz Gjini është ndër tregimtarët më të mirë që ka proza e shkurtër bashkëkohore shqiptare.

Në të njëjtën linjë vjen edhe Faruk Myrtaj, tregimi i të cilit është i ndikuar nga proza e shkurtër amerikane, por që ka edhe mjeshtërinë për ta përzgjedhur dhe përpunuar historinë. Myrtajn e shqetëson zvetërimi i vlerave njerëzore, traumat që la komunizmi tek njerëzit, përthyerjet e qenies së ideologjizuar në shoqërinë e tranzicionit. Brenda këtij realiteti vjen natyrshëm ana tragji-komike (shih tregimet “Luftëtarët vriten në paqe”, “Gjeneralë dhe telenovela”, “Këpucë për gjyqin e fundit”, “Këmbim bustesh”) e përcjellë përmes një rrëfimi të shtruar. Tregimi ndërtohet mbi detajin i cili është më i rëndësishëm se personazhi apo vetë ngjarja (shih tregimet “Zyra e taksave”, “Roba për andej”, “Arvanët”).

Proza e shkurtër shqipe do të ishte e paplotë pa tregimin e Teodor Kekos. Ashtu siç Raymond Carver e solli njeriun e zakonshëm dhe mikrokozmosin e jetës amerikane në tregim, të njëjtën gjë bëri për letërsinë shqipe edhe Teodor Keko, duke sjellë episode domethënëse, plot paradokse dhe drama të vogla njerëzore të Shqipërisë së pas viteve '90. Lënda artistike merret nga përditshmëria e personazheve të thjeshtë; kamerierëve, nëpunësve të administratës, studentëve, emigrantëve, prostitutave, zejtarëve, trafikantët, biznesmenëve, pensionistëve, etj. Ai kap detaje mbi të cilat ndërton historinë, me gjuhë të thjeshtë, teksa ajo kthehet në një lojë, herë zbavitëse dhe herë komike, e herë tragjike për lexuesin. Tregimet sjellin dramën sociale që jeton individi në tranzicion, në

përpyjekjet për të gjetur vetveten dhe për të mbijetuar. Në prozën e shkurtër të këtij autori do të veçonim tregimet “E huaj” dhe “Profeti”.

Edhe Kliton Nesturi sjell tregime refleksive mbi mjedisin ku jeton, duke vëzhguar me imtësi momente të jetës së një shoqërie në tranzicion: jeta e vështirë e emigrantit, bjerrja e identitetit, kriza e marrëdhënieve njerëzore, pasojat e varfërisë, etj. Mes tyre gjendet edhe tregimi me temë historike (“Njeriu me dy varre”). Detaji është më i rëndësishëm se personazhi apo vetë historia në tregimet e Nesturit, ku përpikëqet të përdorë teknikat e tensionit dhe misterit (shih tregimet “Manastiri”, “Shëtitja”, “Ana Bela”, “Në katin e tretë nuk troket askush”). Tregimi në vetvete për Klinton Nesturin nuk shfaqet si një sprovë teknikash narrative por shërben si një kërkim përtej realitetit të përditshëm, si jeta, vdekja, dashuria, miqësia, tradhtia, varfëria, pushteti, etj.

Edhe Albana Shala ka bërë një sprovë në prozën e shkurtër, të cilën e koncepton si një mbresë apo kujtim fëmijërie. Në vëllimin me tregime “Ngarkesa e fëmijës”, vijnë rrëfime si foto të fiksuara të një kohe që ka ikur, një sërë episodesh domethënëse të një të kaluarë që ka lënë gjurmë tek individit në përmasën e tij dramatike.

Leonard Veizi është ndër tregimtarët që e sheh tregimin si eksplorim personazhi. Tregimet e tij “Treni i fundit i metrosë”, “Famulltari” apo “I dënuar me vdekje” sjellin personazhe përmes depërtimeve psikologjike, në procese ndryshimesh të gjendjeve dhe transformimeve të identitetit të tyre. Ndërsa tregimet “Pas shfaqjes” dhe “Helena T” ndërtohen si lojë intertekstuale të teksteve të letërsisë klasike “Romeo dhe Zhuljeta” dhe “Iliada”, ku pasionet njerëzore si sakrificat në çift dhe lufta për femrën/Trojen, vijnë paralelisht me marrëdhëniet njerëzore në ditët tona.

PËRFUNDIME

Paraprakisht, duhet të pohojmë se proza e shkurtër bashkëkohore është në një proces dinamik prurjesh të reja, prandaj ky punim mbetet një lexim i momentit, dhe rrjedhimisht i paplotë, prandaj synohet evidentimi i disa prirjeve dhe dukurive brenda saj. Tregimi shqiptar është dominant në sasi dhe cilësi krahasuar me zhanre të tjera të prozës shqipe, si romani apo novela. Shumica e tregimtarëve kanë lëvruar edhe prozën e gjatë, por disa autorë kanë lëvruar vazhdimisht në kohë tregimin: Mes tyre janë Zija Çela, Ramiz Gjini, Lazër Stani, Arian Leka, Ridvan Dibra, Mira Meksi, Ardian Kyçyku, etj. Gjatë dekadave të fundit ka ndodhur një konsolidim i tregimit modernist dhe janë shfaqur llojet të tjera të tregimit si ai fantastik, postmodernist, etj. Një gjë e tillë ka ardhur për shkak të rritjes së

ndërveprimi të tregimit shqiptar me prozën e shkurtër bashkëkohore botërore. Ashtu siç dikur ka qenë i fortë ndikimi i Çehovit tek tregimtarët shqiptarë, sot konstatohet një ndikim i tillë nga tregimtari postmodernist Borges.

Në lëvrimin e tregimit postmodernist, konstatohet ndërveprim i tregimit me zhanre të tjera letrare dhe ekstra-letrare, duke ardhur në situata midis letërsisë dhe jo-letërsisë, narracionit dhe esesë, esesë dhe poezisë, si dhe shfaqjen e formave të mini-fiksionit të cilat integrojnë elementet jashtëletrare dhe kërkojnë një riformulim të kufijve dhe përcaktimeve të zhanreve kanonike. Disa nga autorët synojnë të demitizojnë realitetin, ta dekonstruktojnë atë përmes një reale më të perceptueshme dhe të kuptueshme. Shenja të tilla shfaqen si kërkesë për një dimension të shtuar të lirisë, thyerjen e tabuve të shoqërive të izoluara, dhe të nevojës së individit për integrim.

Duke privilegjuar raportet objektive për gjendjet abstrakte të mendjes dhe ndjenjës, tregimi modern bëhet kufi prej imazheve, simboleve dhe temave. Intensiteti prodhohet jo nga historia por më tepër nga strategjitë e pikëpamjes, efektet e imazhit dhe tonit, apo ekonomia formale dhe stilistike.

Ndryshimet më të mëdha në tregimin shqiptar kanë ndodhur në aspektin narrativ; konkretisht, në mënyrën sesi ndërtohet historia, në tregimin pa histori apo anti-histori, në mënyrën e përdorimit të instancave narrative, ku dominon rrëfimtari homodiegetik (autodiegetik) dhe në aspektet e pikës së pamjes; këndit të vështrimit, fokalizimit dhe perspektivës.

Pra, shihet përmbysja e modelit klasik apo modernist të tregimit, me parashtrimin, zhvillimi, klimaksi dhe zgjidhja, pra të tregimit që zhvillohet në marrëdhëniet shkak-pasojë, apo në rendin kronologjik dhe po kërkon format e reja të tregimit. Tashmë shihet tregimi si hetim i reales, si zbulim misteri, si prodhim tensioni, duke u përpjekur vazhdimisht të “zgjidhë kufirin midis të njohurës dhe të panjohurës, të dukshmes dhe të padukshmes, sipërfaqes dhe sekretit të brendshëm të gjërave”³¹.

Konsolidimi i tregimit modernist ka evoluar me shfaqjen e formave të tjera të tij, si tregimi fantastik, gjë që konstatohet në prozën e shkurtër të Zija Çelës, Lazër Stanit, Ridvan Dibrës, Romeo Çollakut, etj.

³¹ Shih *The short story: An overview of the history and evolution of the genre*, edited by Viorica Patea, New York, 2012.

Para viteve '90 fantastikja në tekstin letrar prodhohej përmes shartesës me mitin, përrallën, legjendën apo forma të tjera të artit popullor. Sot fantastikja prodhohet përmes lojës mes reales dhe irrealës, ëndrrës dhe realitetit, të dukshmes dhe iluzives, historisë dhe mitit, të tashmes dhe të shkuarës, përmes teknikave narrative dhe mjeteve të tjera letrare.

Prandaj, në tregimin bashkëkohor shqiptar shihet se ka një përdorim gjithnjë e më të madh të misterit, tensionit, intensitetit, në ndryshim nga tregimet e paraviteve '90.

Një tjetër veçori e tregimit bashkëkohor është përdorimi i tregimit parodik, ku spikasin Ylljet Aliçka, Arben Dedja, por edhe autorë të tjerë, si Ardian Kyçyku. Pra, konstatohet përdorim më i gjerë i mjeteve të tilla si ironia me shkallëzimet e saj, të cilat kanë ndërveprim aktiv në prezantimin e realitetit tek lexuesi përmes përzgjedhjes së *frame*-ve, kërkimit të paradokseve, pranëvënies së ligjëtimeve, etj.

Teksti artistik në prozën e shkurtër shfaqet edhe si ndërtim intertekstual, pra vetë teksti shërben si një lëndë për ndërtimin e një teksti tjetër, dhe mbi të ndërtohet një reale tjetër (rasti i Mira Meksit, Gazmend Krasniqit, Arian Lekës, Ardian Kyçykit, Ramiz Gjinit, Zija Çelës, etj.).

Tregimi është një prej mjeteve artistike-letrare më efikas për të shprehur tiparet thelbësore të realitetit, për të kuptuar të thellë shfaqet e saj të mistershme. Përmes prozës së shkurtër, prozatorët shqiptarë kanë filluar ta bëjnë këtë kërkim/hetimi më cilësisht se tregimtarët pararendës, dhe të shfaqin para lexuesit një tjetër dimension lirie përmes fictionit.

LIBRAT NË OBJEKT STUDIMI

Aliçka, Y., *Koha e puthjeve*, Botimet Toena. – Tiranë, 2010.

Çela, Z., *Buza e kuqe dhe gjaku i errët*, Botimet Toena. – Tiranë.

Çela, Z., *Për dashurinë shkruhet pas vdekjes*, Botimet Ideart. – Tiranë, 2007.

Çela, Z., *Pika drite në eklips*, Botimet Toena. – Tiranë, 2012.

Çollaku, R., *Për shtegtarët e pak metrave katërorë*, Botimet Duda. – Tiranë 2009.

Dedja, A., *Kulla e mishit*, Shtëpia Botuese “Pika pa sipërfaqe”. – Tiranë, 2016.

Gjini, R., *Atdhe prej dëbore* Plejad. – Tiranë, 2003.

Gjini, R., *Mendjet e njerëzve, rrëfimet e Bibollit*, Plejad. – Tiranë, 2005.

- Gjini, R., *Posta që sjell era* (tregime të zgjedhura), Botimet M&B. – Tiranë, 2010.
- Gjini, R., *RRëfimet në hije*, Botimet M&B. – Tiranë, 2008.
- Keko, T., *Dymbëdhjetë shenjtorë një profet dhe disa njerëz* (ribotim), botuar nën kujdesin e familjes. – Tiranë, 2006.
- Keko, T., *Hollësi fatale* (ISBN: 9090149013). Libri është botuar nga autori dhe nuk ka emër të shtëpisë botuese dhe vit botimi.
- Keko, T., *Lajmëtarja e vdekjes*, Shtëpia botuese OMSCA”. - Tiranë, 2000.
- Krasniqi, G., *Nëse një ditë një prelud*; Onufri. – Tiranë, 2014.
- Kycyku, A., *Tregime të padukshme*, Botimet Buzuku. – Prishtinë, 2013.
- Leka, A., *Ky vend i qetë ku s’ndodh asgjë*, Tiranë, 1994.
- Leka, A., *Shpina e burrit*, Tiranë, 2005 (ribotim 2017, Botimet Poeteka).
- Leka, A., *Veset e të vdekurve*”, Tiranë, 1997.
- Mehmeti, K., *Anemona*, Botimet Naimi. – Tiranë, 2017.
- Meksi, M., *Flutura mes gjinjëve*, Botimet Onufri. – Tiranë, 2017.
- Myrtaj, F., *Luftëtarët vriten në paqe*, Dukagjini. – Prishtinë, 2003.
- Nesturi, K., *Në katin e tretë nuk troket askush*, Shtëpia botuese OMSCA-1. - Tiranë, 2018.
- Nesturi, K., *Spaletat*, Shtëpia botuese OMSCA-1. - Tiranë, 2016.
- Qazimi, A., *Anatomi e shkurtër pikëllimi*, Botimet Zenit. – Tiranë, 2015.
- Stani, L., *Dënesje në dru*, Ideart. – Tiranë, 2005.
- Stani, L., *Kohë për nuse*, Botimet Fishta. – Lezhë, 2014.
- Shala, A., *Ngarkesa e fëmijës*, Dituria. – Tiranë, 2013.
- Veizi, L., *I dënuar me vdekje*, Botimet Logoreci, - Tiranë, 2006.
- Veizi, L., *Treni i fundit i metrosë*, Shtëpia Botuese OMSCA-1. Tiranë, 2006.

BIBLIOGRAFI

- Aliu, A., *Kur shpirti hapet për universin njerëzor*, (parathënie e vëllimit “Pika drite në eklips”; Botimet Toena. – Tiranë, 2012.
- Berisha, A. N., *Mëvetësi e shtresimit dhe e mbindërtimit poetik të rrëfimit*, (pasthënie e librit Kohë për nuse” e Lazer Stanit); Botimet Fishta. – Lezhë, 2016, f. 173.
- Crabo, C. H., *The art of the short story*, “Charles Scribner’s Sons”. - New York, Chicago, 1913.
- Dushi, L., *Lazër Stani: Tregimtari i përjetshëm*, botuar në gazetën MAPO; shih linkun: <http://www.mapo.al/lazer-stani-tregimtari-i-perjetshem>.

- Gjini, R., *Punëtori i thjeshtë i shkrimtarisë ose letërsia mes meje dhe teje*, artikull botuar tek revista online Fjalareview. Shih linkun: <http://www.fjalaelire.com/tema/33385.html>
- Gjoka, A., *Risi në prozën e shkurtër shqipe*, artikull i botuar në revistën letraro-kulturore online, "Palimpsest", nr. 2: Shih linkun: <https://palimpsest.al/wp-content/uploads/2018/04/revista-palimpsest-nr.-2.pdf>
- Gjoni, S., *Tregimi i viteve '80*, Botimet Albanologjike. – Tiranë, 2017.
- Hoxha, B., *Dy udhë letrare përmes tregimit të Kosovës*, artikull i publikuar tek revista letrare "Saras", linku: <http://revistasaras.al/2016/02/02/dy-udhe-letrare-permes-tregimit-te-kosoves/>
- Hucheon, L., *Poetika e postmodernizmit* (përktheu Demë Topalli, Botimet OM. – Prishtinë 2013.
- Karabolli, B., *Pak fjalë për realizmin magjik*, artikull i botuar në revistën letraro-kulturore online "Palimpsest"; shih linkun: <https://palimpsest.al/2018/05/pak-fjale-per-realizmin-magjik/>
- Kraja, M., *Aventura e njohjes: sprovë për një portret*, artikull i botuar në gazetën "Shekulli", 26 tetor 2009.
- Princ, G., *A dictionary of narratology*, Universiteti i Nebraskës. – USA, 1987.
- Stani, L., *Rruga pa krye* (libër me ese); Botimet Fishta. – Lezhë, 2016.
- Todorov, T., *Hyrje në letërsinë fantastike*, (përkthyer nga Gjovalin Kola), Pika pa sipërfaqe. - Tiranë, 2015.
- The new short stories theories*, përgatitur nga Charles E. May, Ohio University Press, Athens. - SHBA, 1994.
- The short story: An overview of the history and evolution of the genre*, edited by Viorica Patea, New York, USA, 2012.
- Zeqo, M., *Letra e Kadaresë, 52 vjet më parë*, artikull i publikuar më 12 gusht 2018 në gazetën "Dita" Shih linkun: <http://www.gazetadita.al/letra-e-kadarese-52-vjet-me-pare/>

